



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government**

Për :	<b>Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit</b> <b>Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit</b>	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Goran Rakić, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MPL-së</b> <b>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL</b>	
Nga:	<b>Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave</b>	Datë: 10.06.2020 Nr.020-224
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligshmërisë së aktit të komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim përfundimtar Nr. -I- 26, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, në Zonën Kadastrale në Llazarevë/Ofertuesit Baruti Group
I miratuar më datë: 28.02.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 04.03.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim përfundimtar Nr. -I- 26, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, në Zonën Kadastrale në Llazarevë/Ofertuesit "Baruti Group".	<p>Vendimi përfundimtar Nr. -I- 26, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, në Zonën Kadastrale në Llazarevë/Ofertuesit "Baruti Group", është në kundërshtim me Ligjin NR.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht Qarkoren Ligjore të nënshkruar të MPL-së për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës, sipas Nenit 11, <b>Negocimi i ofertave nga Kryetari i Komunës</b>, ku duhet të kompletohet edhe me dokumentin përcjellës:</p> <ul style="list-style-type: none"><li data-bbox="742 801 1385 878">• Vërtetimin tatimor nga ATK se Kompania në fjalë, <u>nuk ka obligime tatimore.</u></li></ul> <p>Andaj bazuar në të lartë cekurat Kuvendi i Komunës së Obiliqit, duhet ta rishqyrtojë këtë vendim, dhe të veprojë në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndër marrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

Za:	<b>Xhafer Gashi</b> , gradonačelnik opštine Obilić <b>Burim Gërguri</b> , predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
Kopija:	Jedinici za administriranje sa dokumentima u MLS-u Jedinici za administriranje sa dokumentima u opštini	
Preko:	<b>Goran Rakić</b> , zamenik premijera i ministar MLS-a, <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MLS-a	
Od:	<b>Venera Çerkini</b> , rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Dana, 10.06.2020 Br. 020-224
Odgovorni službenici:	1. Službenik za potvrđivanje pravne procene <b>Xhevat Tafa</b> rukovodilac Odseka za monitorisanje opština 2. Službenik za izradu pravne procene <b>Ardita Latifi</b> , viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje - akta opštine Obilić	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Konačna odluka br. -I- 26, za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić, u katastarskoj zoni u Lazarevu/ponuđaču "Baruti Group".
Usvojena dana: 28.02.2020
Predložena za razmatranje u MLS-u dana: 04.03.2020

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt nije u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisane u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Konačna odluka br. -I- 26, za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić, u katastarskoj zoni u Lazarevu/ponuđaču "Baruti Group".	<p>Konačna odluka br. -I- 26, za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine Obilić, u katastarskoj zoni u Lazarevu/ponuđaču "Baruti Group" u suprotnosti je sa Zakonom br.06/L-092, o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odnosno Pravnim cirkularom potpisan od strane MLS-a o postupcima davanja na korišćenje imovine, prema članu 11, "pregovaranje ponuda od strane gradonačelnika opštine" uz kompletiranje prateće dokumentacije:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Poreseka potvrda iz PAK-a da navedena kompanija <u>nema poreskih obaveza</u>.</li></ul> <p>Stoga, na osnovu gore navedenog Skupština opštine Obilić, treba da revidira ovu odluku i da deluje u skladu sa zakonodavstvom na snazi</p>

Iz gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana prijema akta za revidiranje akta.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dalja tumačenja u vezi sa ovom procenom.



Orëschkrimi

Nr. -1-26

Data 28.02.2020

Qr.

Ballina

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data 04.03.2020

Njësia organizative	Nr. i Lendës	Gjajca	Vlera
-VI-	920	224	



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 dhe neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe propozim vendimi i Kryearit ne II-142,dt:21.02.2020.Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajture më datë 28.02.2020 mori këtë:

VENDIM

PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË LLAZAREVË

I

Miratohet Vendim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "BARUTI GROUP SH.P.K " me adresë :Mitrovica ,Muhamet Gashi

II

Sipas pikës I të këtij vendimi :

1. "BARUTI GROUP SH.P.K " është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës
2. Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale si në vijim P-72614041-00124-05 , me sipërfaqe të përgjithshme prej 5000 m<sup>2</sup>, Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KK OBILIQ . Sipas nenit 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092
- 3 .Shfrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit të këtij afati pronat i kthehen titullarit .
- 4 .Në pronën e paluajtshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të "BARUTI GROUP SH.P.K "

### III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

### IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

### V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

### VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.


### VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Kuvendi i Komunës së Obiliqit**  
Nr. I- 26 - , më 28 Shkurt 2020

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- MAPL
- DPUKP
- DMM
- DEZHF
- DI
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**BUSHM GËRGURI**



Datës-lidhës:

Nr. -1-26  
Br.

Data 28.02.2020  
Datum

OBILIĆ, OBILIĆ

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

U skladu sa članom 12.14.2, tačka 17c) Zakona o lokalnoj samoupravi br.03 / L-040, Službeni glasnik Republike Kosovo br. 28 od 4. juna 2008., člana 3. tačka 1.4, člana 6 tačka 1.2, člana 8 tačka 1.3 i član 11 tačka 3.1 Zakona o zakupu i razmeni nepokretne imovine opštine br.6 / L-092, član 44.1 i 47.3 Statuta opštine Obilić br. 1-34 od 25.04.2016 i član 39 Poslovnika o radu Skupštine br. 1-95 od 29.06.2018. i predlogu predsednika Opštine II-142, od: 21.02.2020. Skupština opštine je na svojoj sednici održanoj 28.02.2020.donela sledeću:

ZAKLJUČNU ODLUKU  
ZA DUGOROČNU UPOTREBU NEPOKRETNJE SVOJINE OPŠTINE OBILIĆ U  
KADASTRALNOM PODRUČJU LAZARVA

I

Usvaja se Odluka o dodeli nepokretne imovine opštine na dugoročno korišćenje ponudaču "BARUTI GROUP SHPK" sa adresom: Mitrovica, Muhamet Gashi.

II

Prema tački I ove odluke:

1."BARUTI GROUP SH.P.K" je korisnik nepokretne imovine opštine

1. Imovina opštine se nalazi u katastarskoj zoni Lazarevo u sledecim katastarskim jedinicama:

P-72614041-00124-05, ukupne površine 5000 m<sup>2</sup>, lokacija nazvana ruralnim područjem „Haredhia“,Lazarevo, prema opštinskom razvojnom planu parcela je industrijska površina, evidentirana u potvrdi o imovini u ime DI .SO OBILIC. prema članu 11. tačka 3.1 Zakona o zakupu i razmeni nepokretne imovine opštine 06 / L-092.

3 . Korišćenje imovine traje 99 godina od dana stupanja na snagu ove odluke, nakon isteka ovog roka imovina će se vratiti vlasniku.





3 . Korišćenje imovine traje 99 godina od dana stupanja na snagu ove odluke, nakon isteka ovog roka imovina će se vratiti vlasniku.

4 . Na nepokretnoj imovini opštine biće izgrađen objekat za potrebe "BARUTI GROUP SH.P.K"

### III

Upotreba nepokretne imovine iz tačke II vrši se uz naknadu.

### IV

Prava i obaveze strana uređuju se ugovorom između gradonačelnika i korisnika nepokretne imovine opštine.

### V

Za sprovođenje ove odluke zaduženi su gradonačelnik, Uprava za urbanizam, imovinu i katastar, Uprava za zaštitu životne sredine, Uprava za ekonomiju i razvoj i Uprava za inspekciju

### VI

Direkcija za urbanizam, katastar i imovinu dužna je da nakon završetka procedura za dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine u katastarskim knjigama upiše imovinu koja je data u dugoročnu upotrebu.

### VII

Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokolarnom uredu, MALS-a kao i 7 dana nakon objavljivanja na opštinskoj veb stranici.

**Skupština Opštine Obilić**

Br. I- 26 - , 28 februara 2020

Dostaviti:

- Gradonačelniku
- Preседavajućem
- MALS-u
- DUPKI
- DZZS
- DPFRR
- DI
- stranki
- Članovima Skupštine



**Preседavajući Skupštine Opštine**

**Burim Gërguri**





Titulli i titullit

Nr. -11-142 Data 21.02.2020  
Drejtori Datum

Titulli i titullit



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 58 pika (h), neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016, Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.1-47 dt.24.05.2016 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit për ngastrat Kadastrale Nr.00124/2 dhe nr.00126/1 zc.Llazarevë të cilat pastaj janë parcializuar dhe janë krijuar parcela të reja.Pas negociatave të Kryetarit të Komunës ku të pranishëm kanë qenë edhe Bordi i Drejtorëve si dhe Shefat e grupeve të Kuvendit Komunal dhe deputetët në njëri anë dhe Investitorit "BARUTI GROUP" Sh.P.K. për Njësitë Kadastrale Nr.00124-5 me sipërfaqe 5000m<sup>2</sup> të cilat janë pjesë përbërse e Regjistrit të Pronave Komunale të cilat gjenden në web faqen e Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës, të miratojë këtë :

## PROPOZIM

### VENDIM

## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

### Neni 1

Me këtë Vendim i jepen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Investitorit "BARUTI GROUP" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë –Muhamet Gashi, Njësia Kadastrale si në vijim:

Nr.00124-5 me sipërfaqe të përgjithshme prej 5000m<sup>2</sup>, Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zc.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.Kuvendi Komunal OBILIQ .

### Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore

### Neni 3

Obligohet Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

### Arsyetim


Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092 dhe të nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 sipas autorizimeve të veta në prani të Bordit të Drejtorëve si dhe Shefave të grupeve të Kuvendit Komunal dhe deputetët me datë 20.02.2020 ka negociuar me ofertuesin "BARUTI GROUP" Sh.P.K. me Adresë Mitrovicë – Muhamet Gashi dhe sipas projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të ndërtoj Fabrikën e Lëngjeve Frutore vlera e përgjithshme e investimeve në këtë projekt do të jetë 9,000.00€ . Përveq rritjes së vlerës së Pronës Komunale nga ky projekt sipas Projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku përparsi do të kenë banorët e Komuns së Obiliqit .

Andaj me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale të dy investitorve të lartëcekur dhe siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi, kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

KRYETARI I KOMUNËS

Xhafer Gashi







Dalës-izlazar:

Nr. 11-156  
Br.

Data 03.03.2020  
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	02/03/2020
Nga/Od/From:	Xhafer Gashi- Kryetar i Komunës
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal
Tema/Subjekat/Subject:	Njoftim



Zyra e Kryetarit të Komunës ju njofton se pas rishiqimit të Propozim Vendimit Nr.II-142 të dt.21.02.2020 ka vërejtur se në faqen e dytë të këtij Propozim Vendimi në pjesën Arsyetuese është përvjedhur një gabim teknik ashtu që është vendos gabimisht citoj " sipas projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të ndërtoj fabrikën e Lëngjeve frutore vlera e përgjithshme e investimeve në këtë projekt do të jetë 9,000.00 € ( nëntë mijë euro) " fshihet ky gabim teknik dhe duhet të jetë sipas projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartëcekur të ndërtoj fabrikën e Lëngjeve frutore vlera e përgjithshme e investimeve në këtë projekt do të jetë 900 000,00 € ( nëntëqind mijë euro) .

Andaj duke e vërejtur këtë gabim teknik Zyra e Kryetarit të Komunës bëri korrigjimin e Propozim Vendimit Nr.II-142 të dt.21.02.2020 në faqen e dytë në pjesën Arsyetuese ashtu që është korigjuar vlera investive nga 9,000.00 € ( nëntë mijë euro) në 900 000,00 € ( nëntëqind mijë euro) në vlerën reale të paraqitur në projektin investiv të ofruar nga Ofertuesi . .

Me respekt !





DIREKTORIA E ADMINISTRATËS PËRCJFTSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lidhura

Nr. I-47  
Gr.

Data 24.05.2016  
Datum

NEEN IN. NR. 111/16



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, e Ligjit Nr-04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës ( "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012" ) nenit 5 lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluejtshme të Komunës, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.24.05.2016, mori këtë:

## VENDIM

- I. Aprovohet Propozimi paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës së Obiliqit, në zonën kadastrale Llazarovë dhe atë:
  - Ngastra kadastrale nr.00124/2, në sipërfaqe prej 211369 m<sup>2</sup>
  - Ngastra kadastrale nr.00126/1, në sipërfaqe prej 27115 m<sup>2</sup>
- II. Obligohet DPUKP, dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me Komisionin për vlerësimin e pronave të paluejtshme të Komunës, ti zhvilloj procedurat e konkurimit të hapur konform dispozitave të ligjit të cekur më lartë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

T'i dërgohet

- Kryetarit,
- Nënkryetarit,
- Kryesuesit,
- MAPL-së,
- DPUKP,
- Këshilltarëve,
- Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit komunal

Adem Preniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Mës-izlazna

Nr. 11-244  
Br.

Data 19.04.2016  
Datum

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIC  
MUNICIPALITY OF OBILIC

Në mbështetje të nenit 12,14,17 pika c) dhe nenit 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e radhës të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

#### VENDIM

#### **PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE LLAZAREVË**

#### Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë në ngastrën kadastrale:

-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m<sup>2</sup> e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m<sup>2</sup> e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.



## Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së lartëcekur është zhvillimi i veprimtarisë industriale respektivisht ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese apo përpunuese sipas standardeve të përcaktuara me dispozita ligjore.

## Neni 3

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, prona ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-136 të dt.31.10.2014, si dhe Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

## Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Inspeksionit si dhe Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

## Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

## Arsyetim


Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e neneve 12,14, 17 pika c) dhe neni 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 69 pika 4 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.01-51-2010 të datës 10.03.2010.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komunale si dhe ruajtjes së mjedisit Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatgjatë në periudhë prej 99 vitesh pronat e paluajtshme që gjenden në zonën kadastrale në Llazarevë.



-Ngastra kadastrale P-72614041-00124-2 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore ,kullosë e kl.3-të me sipërfaqe prej 211369 m<sup>2</sup> e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit.

- Ngastra kadastrale P-72614041-00126-1 në vendin e quajtur "Harëdhia" me kulturë tokë bujqësore,kullosë e kl. 3-të me sipërfaqe prej 27115 m<sup>2</sup> e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-2467-2015 e dt.26.11.2015 ZK.Llazarevë e evidentuar si Pronë Shoqërore e Fshatit,ipen në shfrytëzim në mënyrë që subjekteve të ndryshme t'u mundësohet të ofertojnë për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës komunale.



Shtojcë :

- Çertifikatë –Njësia Kadastrale
- Kopja e Planit
- Orto-foto



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : OBILIQ

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Llazarevë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-72614041-00124-5	Parcelë / Parcela / Parcel	5000,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:768

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 21.02.2020

Koha/ Vreme/ Time: 11:19:14

Nënshkrimi/Potpis/Sigantura:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Sigantura:



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MIEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72614041-00124-5

Numeri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 05-447/2020  
